



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI

Departamenti i *Histori Gjeografisë* në Fakultetin e Shkencave Humane në Universitetin e Elbasanit “Aleksander Xhuvani” për nevojat e tij për zhvillimin e procesit mësimor për vitin akademik 2022-2023 shpall konkurs për personel akademik me kohë të pjesshme.

Kriteret e **përgjithshme e të veçanta** për pozicionin e punës **personel akademik me kohë të pjesshme** janë:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare brenda ose jashtë vendit (Ba dhe Master i Shkencave ose ekuivalente me të) në shkencë humane, fusha *Histori, Arkeologji*, me notë mesatare mbi 8.0. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
2. Kandidati duhet të ketë mbajë *titullin/ gradën Profesor/ Doktor /Master i shkencave* në fushën e *Arkeologjisë/Historisë* (Titujt/Gradat e fituar brenda ose jashtë vendit e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
3. Të ketë përvojë në mësimdhënie akademike si dhe të jetë i angazhuar aktualisht në fushën e mësimdhënies e të kërkimit shkencor.
4. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj perëndimore, (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) të mbrojtur dhe të vërtetuar me dëshmi.
5. Parapëlqehet të ketë marrë pjesë në konferenca shkencore e botime në fushën e *Historisë, Historisë Botërore Bashkëkohore dhe Arkeologjisë*.
6. Kandidati do të për zgjidhet mbi bazën e ekperiencës.
7. Të jetë gatshëm të përfshihet në mësimdhënie sipas orarit të përcaktuar nga drejtuesi i departamentit, sekretaria, pa kufizim kohor gjatë një dite mësimore.
8. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna;
9. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;

Kandidatët **duhet të dorëzojnë** nga data **14.09.2022** deri **23.09.2022** këto dokumente:

1. Kërkesë me shkrim (Plotësimi i formularit të aplikimit)
2. Jetëshkrimi.
3. Kopje të diplomës dhe të listës së notave. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

4. Dokumentacionin shoqërues përkatës origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura etj.
5. Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës.
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti)
7. Raporti i aftësisë në punë.
8. Fotokopje e letërnjoftimit.
9. Librezë shëndetësore.
10. Leje nga punëdhënësi për mësimdhënie në UE

Përveç konkurrimit me dosje aplikantët do t'i nënshtrohen *intervistës me gojë* në departament.

Dokumentacioni i kërkuar mund të dorëzohet në **rrugë postare 14.09.2022** deri **23.09.2022**.

Adresa postare:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim në Fakultetin e Shkencave Humane
Departamenti i Histori Gjeografisë
Elbasan**